



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më
29.7.2024, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, (i pavarur), kryesues i Kuvendit, Tiera Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Berna Saraçi (LVV), Feim Osmani (LVV), Arbër Limani (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Fatmir Dervishi (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Xhavit Ahmeti, (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

Munguan: Berat Lahu (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Amir Simnica (LDK) dhe Shegë Beqiri-Badivuku (PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar, Alban Zogaj, nënkryetar, Valbona Ajeti, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Sibel Halimi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Doruntinë Maloku, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës, Kushtrim Mushica, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Donika Çetta, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të medieve.

Faqe 1 nga 9

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit, i cili tha se znj. Valbona Vitia dhe z. Kushtrim Mushica kanë dhënë dorëheqje nga pozita e këshilltarit komunal nga subjekti politik i AAK-së, dhe zëvendësohen me anëtarët e rinjë, me znj. Bukurie Canolli dhe z. Xhavit Ahmeti, të cilët u ftuan nga kryesuesi që ta bëjnë betimin para Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

Sami Salihu, në cilësinë e anëtarit të Komisionit komunal të aksioinarëve në NP "Prishtina Parking", kërkoi që pika 4 e rendit të ditës: "Propozim-vendimi që laura e Gërmisë të kalojë në ndërmarrjen publike lokale "Gjelbër", të tërhiqet nga rendi i ditës, pasi që kjo ndërmarrje nuk është profilizuar që ta bëjë menaxhimin e laurës, e që ky propozim bie ndesh me rregulloren që e kemi votuar të gjithë së bashku.

Leutrim Retkoceri tha se, si propozues i pikës 3 të rendit të ditës: "Propozim-vendimi për ndryshimin e emërimit të rrugës "Ibrahim Lutfiu" me rrugën "Faruk Begolli", kërkoi që të hiqet nga rendi i ditës, të shtyhet për ndonjëherë nga seancat e radhës së Kuvendit, derisa Komisioni për riemërim, emërim dhe ndryshim të emrave të ketë kohë që t'i përpunojë kërkesat.

Arbër Sadiku kërkoi nga anëtarët e Kuvendit, që pika: "Propozim-vendim për ndryshimin e riparcelimit sipas gjendjes aktuale katastrale të banimit individual të Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim" dhe ndërrimin e destinimit të BLL.I-1 , Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së, e cila u hoq nga rendi i ditës në mbledhjen e KPF-së, të futet sot në rend të ditës për diskutim.

Gëzim Sveçla, lidhur me propozimin e Arbër Sadikut, tha se në mbledhjen e KPF-së i kemi paraqitur shqetësimet tona lidhur me këtë propozim-vendim, andaj edhe sot jemi kundër, që kjo pikë të futet në rend të ditës për diskutim.

Lidhur me propozimin e Arbër Sadikut, drejtor, dhe shqetësimet e ngritura nga z. Sveçla, sqarime të nevojshme dha Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore.

Leutrim Retkoceri theksoi se sa i përket propozimit të z. Arber Sadiku, ne nuk mund të përkrahim një vendim të tillë, përderisa kjo çështje ka zgjidhje ligjore edhe zgjidhje të kompetencës që do të duhej t'i ofronte Drejtoria e Urbanizmit, që t'i bëhej zgjidhje asaj zone për leje individuale të ndërtimeve.

Bahri Gashi propozoi që në rend të ditës të futet edhe pika: "Propozim -vendimi për ndryshimin e Vendimit për caktimin e komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në përzgjedhjen e këshillave lokalë të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane", që ish-anëtarja e këtij komisioni, znj. Valbona Makolli, të zëvendësohet me njërin nga përfaqësuesit e subjektit politik të AAK-së.

Gëzim Mehmeti tha se sa i përket propozimit të z. Arber Sadiku, që ky Propozim - vendim të futet në rend të ditës për diskutim, mendoj se ka shumë mungesa informative. Po ashtu, sipas këtij propozim-vendimi, shihet se në ato parcela nuk ka ndryshim të koeficienteve, nuk ka banime të larta, domethënë janë të gjitha banime individuale.

Agim Kuleta tha se Komiteti për Politikë dhe Financa ka të drejtën të rekomandojë diçka, por jo të marrë vendime që të hiqet pika nga rendi i ditës, ta ndryshojë rendin e ditës.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e dhëna si në vijim:

Kryesuesi konstatoi se më 20 vota për, 10 kundër dhe 12 abstenime, u miratua propozimi i z. Salihu për tërheqjen e pikës 4 nga rendi i ditës: "Propozim-vendimi që laura e Gërmisë të kalojë në ndërmarrjen publike lokale "Gjelbër"".

Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për dhe 21 kundër, u miratua propozimi i z. Arbër Sadiku, që pika "Propozimi-vendimi për ndryshimin e riparcelimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (të banimit individual) të Planit rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" dhe ndërimi i destinimit të BLL.I-1 ,Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së , në Prishtinë, hyn në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për dhe 13 abstenime, u miratua propozimi i z. Bahri Gashi, që pika: "Propozim -vendimi për ndryshimin e Vendimit për caktimin e komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në përzgjedhjen e këshillave lokalë të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane", hyn në rend të ditës për diskutim.

Me ndryshimet dhe plotësimet e propozuara, më 26 vota për, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershor 2024 (TM2);
3. Propozim-vendimi për përkrahjen financiare të klubeve sportive të Kryeqytetit dhe Eventit sportiv 3x3 Prishtina;
4. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për kompaninë e menaxhimit të deponive në Kosovë (KMDK), SHA;
5. Propozimi-vendimi për ndryshimin e riparcelimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (të banimit individual) të Planit rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim " dhe ndërimi i destinimit të BLL.I-1 ,Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së në Prishtinë;
6. Propozim - vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për caktimin e komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në teren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, nr. 01 – 020/07-257562/22;
7. Raporti i përgjithshëm i punës së ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusave" SHA Prishtinë;
8. Raporti i punës së ndërmarrjes publike lokale për vitin 2023-2024 "Sport Marketing" SHA;

Faqe3nga9

9. Informatë mbi punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
10. Pyetje dhe përgjigje;
11. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit.

Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për dhe 1 kundër, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pike dytë

Raporti financiarë buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill -30 qershor 2024 (TM2).

Lidhur me Raportin financiarë buxhetor të Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill -30 qershor 2024 (TM2), të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtore.

Feim Osmani tha se vërehet qartë nga të dhënat e paraqitura në këtë raport, se ende po vazhdon trendi negativ i performances, ku vërehet se performanca e të hyrave është për 15% më e ulët sesa vitin paraprak. Në shumë kategori të investimeve kapitale vërtetohet një dështim në realizimin e të hyrave në kategoritë më të rëndësishme, siç janë të hyra nga inspeksioni dhe të hyrat nga mbeturinat, këto janë shumë të rëndësishme se gjendja në këto dy segmente është jashtëzakonisht e rëndë. Po ashtu, shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë shënuar rritje të konsiderueshme në krahasim me vitin 2023, e që arsyet nuk janë paraqitur në këtë raport. Gjithashtu, janë disa pagesa të ekzekutuara që duhen të arsyetohen para anëtarëve të Kuvendit, nga se si vepra kapitale nuk duken fare në terren etj. Ky raport ka shumë të meta, disa nga ato kanë qenë edhe të gjetura në raportin e auditimit. Më konkretet shihet çështja e shpenzimeve nga përfaqësimi juridik, ku janë dhëne informata për pagesa të shumave të konsiderueshme.

Fiknete Bejta theksoi se ky raport paraqet performancën financiare të Komunës së Prishtinës dhe, përkundër faktit që janë paraqitur të gjitha faktet financiare, shifrat tregojnë shumë qartë që trendi i performancës financiare të shpenzimeve është trend pozitiv nëse e krahasojmë më periudhat e njëjta të 3 viteve të fundit. Po ashtu, mund të konstatojmë se te rritja e të të hyrave ka ndikuar edhe vendimi i vitit të kaluar për faljen e tatimit në pronë, kështu që në analizojmë si tërësi performancën e të hyrave vetanake, kemi një performancë të kënaqshme, pra kemi një vit, një periudhe të kënaqshme të realizimit buxhetor si në aspektin e të hyrave, ashtu edhe për performancën buxhetore të shpenzimeve, e që është një trend pozitiv i shpenzimeve buxhetore.

Muhamet Selmani tha se te investimet kapitale të projekteve shohim që shumica dërmuese e projekteve nuk kanë filluar fare dhe pjesa që ka filluar, është e realizuar përafërsisht 10% si total i investimeve kapitale dhe kjo është shqetësuese për qytetin e Prishtinës. Po ashtu, shqetësuese në këtë raport shihen edhe shifrat e mjeteve financiare të cilat janë të parapara për një numër të projekteve të ndryshme, e që konsideroj se janë mjete financiare jo të

Faqe4nga9

mjaftueshme për realizimin e atyre projekteve, andaj për këtë çështje kërkoj një sqarim prej drejtorive përkatëse. Për këtë periudhë kohore janë shpenzuar vetëm 10% të këtij buxheti, dhe nëse e krahasojmë me shpenzimet totale të buxhetit në raporte me vitit 2023 në përqindje është 50% më i dobët, për këtë arsye nuk mundë të kënaqem me këto shpenzime. **Nora Kelmendi** tha se shumica e projekteve që janë të paraqitura në këtë raport, ato ende nuk kanë filluar të realizohen, kështu që ku është arsyeja që ato i keni parashikuar për realizim. Shumica prej drejtorive nuk e ka realizuar asnjë projekt, ndërsa disa nga drejtoritë kanë realizuar disa projekte me një përqindje shumë të vogël, kështu që kërkoj të dijë nga drejtorët e drejtorive përkatës se kur do të fillojnë me i realizuar projektet e planifikuara. **Gëzim Sveçla** tha se sa i përket këtij raporti, kërkoj një sqarim nga drejtorët e drejtorive përkatëse rreth kodeve buxhetore që janë të parapara për realizimin e atyre projekteve, siç janë projekti për ndërtimin e objektit të zjarrfikësve, projekti për ndërtimin e aneksit të Komunës, projekti për ndërtimin e parqeve dhe hapësirave të reja publike rekreative, ndërtimi i tri mbikalimeve në lagjet "Aktashi", "Lakërishta" dhe "Arbëria", rregullimi i sheshit "Xhorxh Bush", ndërtimi i ishullit urban në lagjen "Arbëria", vendosja e kontejnerëve mbitokësorë dhe nëntokësor, ndërtim i qoshqeve, si dhe disa projektet të tjera, dhe për të gjitha këto kërkoj përgjigje nga drejtorët e drejtorive përkatëse. **Gëzim Mehmeti** kërkoj sqarim nga drejtori i Drejtorisë së Investimeve Kapitale, lidhur me mbikalimin dhe kontestin pronësor- juridik me Infracosin, ku sipas një vendimi të vitit 2020 të Qeverisë, prona i ka kaluar për 99 vjet Komunës për shfrytëzim dhe prapë Infracosi ka kompetenca në atë pronë, kur ajo tani menaxhohet nga Komuna e Prishtinës. **Leutrim Retkoceri** kërkoj të di se shuma e mjeteve për ndërtimin e projektit të Qendrës së grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave ndërtimore, këto mjete a janë të dedikuara vetëm për një qendër të grumbullimit apo për më shumë qendra.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë Krenar Xhaferi, drejtor, Adelina Sahiti, drejore, Valbona Makolli, drejtore, Donika Çetta, drejtore dhe Bekim Brestovci, drejtor.

Pika e tretë

Propozim-vendimi për përkrahjen financiare të klubeve sportive të Kryeqytetit dhe Eventit sportiv 3x3 Prishtina.

Për këtë propozim-vendim, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Kushtrim Mushica, drejtor.

Nora Kelmendi tha se, bazuar në Rregulloren e Komunës së Prishtinës, ndarja e subvencioneve mund të bëhet në bazën e thirrjes publike apo me raste të veçanta. Arsyetimet e mëhershme se kemi të bëjmë me raste të veçanta nuk qëndrojnë, sepse rastet e veçanta zbatohen vetëm kur lejohen me dispozita ligjore të rregullores. Kjo është hera e tretë që na sillet kjo pikë pa thirrje dhe shpallje publike dhe pa konfirmim të ligjshmërisë. Me

rastin e ndarjes së subvencioneve nga ana e Komunës, Komuna nuk ka bërë monitorimin e subvencioneve dhe subvencionet nuk janë shfrytëzuar për qëllimin e dhënë. Ne nuk jemi kundër përkrahjes financiare të klubeve sportive, po gjithmonë do të jemi kundër shkeljeve ligjore, shkeljeve të cilat ju po i bëni me vetëdije të plotë.

Lindita Rexhepi u shpreh se përkrahja për klubet e sportit është një vendim i vlerësuar, që ndihmon nxitjen dhe mbështetjen e aktiviteteve sportive. Ne si Grup i Lidhjes Demokratike të Kosovës, natyrisht që e mbështesim këtë propozim vendim për miratim.

Leutrim Retkoceri tha se sa i përket këtij Propoziti-vendimi për ndarjen e subvencioneve klubeve sportive, ne si Grup parlamentar për hir të afirmimit të sportit dhe situatës së rëndë ekonomike, duhet t'i mbështesim kësaj here, ndërsa presim që vitin e ardhshëm që të bëhen ndryshime të nevojshme që subvencionimi mos të jetë në fatin e një shkeljeje procedurale.

Bahri Gashi tha se edhe ne jemi për për t'i përkrahur këto klube sportive, sidomos të jetë një përkrahje edhe për klubet sportive të femrave.

Sami Borovci tha se jemi për t'i financuar këto klube sportive, por do të ishte mirë që paraprakisht të investohet në infrastrukturën e tyre, pasi që kemi të padefinuara çështjet pronësore të shumë klubeve me stadiumet e tyre, e kjo të pamundëson edhe me investuar, kështu që inkurajoj me u fokusuar shumë në këtë drejtim, sepse mendoj që kjo ka me i rritur edhe ka me i konsoliduar pak më shumë klubet sportive.

Endrit Zabërgja shprehu mendimin se sporti është një prej ambasadorëve më të mirë edhe të Prishtinës, por edhe vendit tonë, dhe pa dyshim që ka nevojë me e mbështetur. Ne vazhdimisht duhet me punua në përmirësimin edhe të infrastrukturës ligjore, por edhe të infrastrukturës logjistike, në mënyrë që edhe klubet sportive, por në të njëjtën kohë edhe organizatat rinore, me pasur qasje më të lehtë dhe me pasur mundësi më të mirë në gjetjen e ndihmës së tyre.

Arianit Beqiri tha se ne duhet ta kemi një strategji të zhvillimit të sportit, kështu që mendoj se së pari duhet fokusuar në shkollimin e hershëm të fëmijëve në klubet e reja dhe sporti në Prishtinë me qenë sport për të gjithë e jo vetëm sport elitare, kështu që me rastin e subvencionimit të klubeve sportive, do të ishte më se e arsyeshme që të merren parasysh disa kriteret të përzgjedhjes. Gjithashtu, paraprakisht do duhej rregulluar infrastruktura sportive, pasi që shumë klube sportive aktivitetet e tyre i zhvillojnë në terrenet sportive të komunave tjera etj.

Gëzim Sveçla tha se para një jave është diskutuar çështja e këtyre subvencioneve në mjetet e informimit, ku ka pasur artikuj të shumtë mediatikë gazetaresk për këto shkelje që kanë ndodhë në Komunën e Prishtinës dhe përsëri na vjen i njëjti propozim me i bërë të njëjtat shkelje. Sporti ka nevojë për përkrahje, por mënyra se si po ndahen këto subvencione konsideroj se nuk qëndron një veprim i tillë, kështu që të subvencionohen klubet sportive të cilat nuk ka arritur asnjë sukses, mendoj se është e pajustificueshme. Po ashtu, kërkoi të dijë se këto subvencione që po duan t'i ndajnë sot a janë në përputhshmëri me rregulloren për financimin e OJQ-ve dhe rregulloreve tjera të Komunës.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dhanë Alban Zogaj, nënkryetar, Kushtrim Mushica, drejtor, dhe Fatos Dibra, përfaqësues nga Zyra ligjore.

Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, 15 kundër dhe 1 abstenim, u umiratua Vendimi për përkrahjen financiare të klubeve sportive të Kryeqytetit dhe Eventit sportiv 3x3 Prishtina.

Pika e katërt

Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për kompaninë e menaxhimit të deponive në Kosovë KMDK, SHA.

Për këtë propozim-vendim, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtore.

Gëzim Sveçla tha se është krejtësisht mungesë vizioni trevjeçar që neve na sjellë në të njëjtën pozitë që diskutimet e para tri viteve me i përsëritur. Ne si LVV kemi thënë që nuk bën kështu, nuk është ideja për me i subvencionuar, por ato ndërmarrje duhet me u mirëmbajtur dhe mbas tri viteve prapë e njëjta gjë, domethënë për tri vite kemi stagnuar. Ne sot po i votojmë 200 mijë euro dhe çka do të ndodhë nesër, a ka një plan se si ka me u paguar pjesa tjetër e borxhit, nëse kemi vendosur me e paguar këtë borxh dhe mos të merremi me këtë çështje, nëse kjo është zgjidhja që na garanton një qytet të pastër.

Jeta Rafuna tha se, duke pasë parasysh diskutimin e drejtorit, që përveç rritjes së faturimit të tyre, pajtohëm që vetëm me kusht që ai menaxhment të japë dorëheqje, ne si LDK e votojmë kërtë propozim-vendim.

Leutrim Retkoceri tha se do të ishte mirë që borxhi ndaj kësaj kompanie të mbyllet në tërsë e jo të jepen vetëm 200 mijë euro. Pra është abnormale dhe jo në rregull me funksionuar ashtu në aspektin e zgjidhjes së këtij problemi. Jeni mburrur se u rregullua pastrimi dhe shohim se si është gjendja, përsëri ka ardhur në nivelin e njëjtë, se zgjidhja është e përkohshme, e kur bëhen zgjidhje të përhershme, atëherë duhet me i trajtuar si duhet, tani edhe me kërkuar mbështetje të Kuvendit edhe gjithësecilit për me përmirësuar, me i ndihmuar, jo me i kushtëzuar.

Bahri Gashi tha se kompanisë "Pastrimi" duhet me i ndihmuar. E dimë se kjo asamble e ka themeluar atë ndërmarrje dhe kjo asamble e ka për obligim me u marrë me atë ndërmarrje. Do të ishte mirë që kjo ndërmarrje të menaxhohet ashtu si duhet, të mbyllet ai borxh njëherë e përgjithmonë dhe me vazhduar ndërmarrja me punua pa probleme. Ne jemi për me e ndihmuar edhe ndoshta për me e rritur atë subvencion dhe me e kaluar këtë problem.

Gëzim Mehmeti kërkoi të dijë se cilat janë borxhet që ndërmarrja lokale publike "Pastrimi" ka ndaj KMDK-së, dhe a ka borxhe të tjera, pse për këto borxhe nuk jemi të informuar. Kërkojmë nga përgjegjësit e kësaj ndërmarrjeje të na informojë me të gjitha aspektet, pse është bërë një propozim-vendim dhe pse duhet që pas dy-tri viteve të paguet ky borxh! Nga ne po kërkohet që ta marrim një vendim për subvencion, ndërsa në anën tjetër ne nuk kemi të dhëna specifike!

Endrit Zabërgja theksoi se kompania "Pastrimi" tani e disa mandate ka pasur një degradim të madh politik e partiak prej kujdo që është sjellë andej dhe duke e pasë parasysh që shërbimet e kësaj ndërmarrje nuk janë të mjaftueshme për kryeqytetin, nëse kishin qenë të

Faqe7nga9

mjaftueshme këto shërbime, atëherë situatën në kryeqytet e kishim pasur ndryshe.

Personalisht, kam hezitime në raport me votimin, duke e pasur parasysh që një menaxhim i tillë tani 3 vjet nuk ka sjellë rezultat, mendoj se duhet me pasur ndryshime në secilin prej ndërmarrjeve, pra është më se e rëndësishme me u trajtuar problemi i qytetrëve.

Muhamet Selmani tha se Prishtina duhet të llogarisë rreth 500 mijë euro që ka borxh ndaj KMDK-së, ashtu ka qenë edhe marrëveshja kur kam qenë unë aksionar, që me u mbuluar ky borxh, andaj ropozoj që në vend të 200 mijë eurove të jetë propozimi për 500 mijë euro dhe të mbulohet në tërësi ky borxh ndaj KMDK-së, kështu që të jemi të çartë se ky borxh është një obligim i trashëguar dhe duhet ta mbulojmë.

Feim Osmani tha se kriza në ndërmarrjen "Pastrimi" dhe me mbeturinat në Prishtinë nuk është e tashme, është më shumë se dy vjet që ndërmarrja kërkon të subvencionohet, të ndihmohet rreth pagesave të borxheve dhe nuk ka ofruar shërbime të kënaqshme asnjëherë. Nuk ka kuptim në njërën anë operatorit privat t'i jepet kontrata milionëshe dhe në anën tjetër të shpenzohen miliona euro nga ndërmarrja me një menaxhim jashtëzakonisht të keq dhe të pasuksesshëm dhe Prishtina të jetë në krizë. Kryetari Rama është dashtë që këtë çështje ta diskutojë me ndërmarrjen dhe ta gjejë zgjidhjen.

Granit Geci tha se duke pasur për bazë diskutimet rreth kësaj pike, kërkoi të dijë se, a është pika ku kemi me bër diskutim për performancën e menaxhmentit, apo kemi me përfundua një pagesë e cila është obligim. Ky borxh po konsiderohet se është i trashëguar dhe nëse me këtë borxh e ngarkojmë dik tjetër, mendoj se këtu nuk mundemi me e bër zgjidhjen e problemit.

Hafiz Krasniqi tha se sa i përket kësaj çështjeje, është krijuar një situatë jashtëzakonisht e rëndë në raport me kompaninë publike komunale KMDK, që është kompani publike qendrore, vetë forma e vendimit po më duket pak se nuk është e sqaruar mirë, për arsye se duhet të jetë shumë më shumë vendim për përkrahje ndërmarrjes publike komunale "Pastrimi" për pagimin e borxhit të KMDK-së, se jo të shkohet direkt t'i paguhet KMDK-së. Nuk e besoj që kemi të drejtë ne si qeveri komunale të paguajmë një kompani publike qendrore drejtëpërdrejt, besoj që këtu ka shkelje ligjore. Jemi që ta bëjmë një hap përpara në mënyrë që ta lirojmë KMDK-në, të ketë mundësi t'i pranojë mbeturinat.

Fiknete Bejta theksoi se çështja e pastrimit është tërësisht çështje e shëndetit publik dhe meqenëse është kështu, jemi pajtuar edhe me qytetarët që janë ankuar tash e sa muaj, që gjendja ka qenë shumë alarmante dhe tani ajo është normalizuar me shërbimet që i kryen ndërmarrja "Pastrimi". Për dhënien e këtyre subvencioneve, ne kemi arsye të fortë që të kërkojmë llogari prej menaxhmentit, që secili menaxhment që vije në krye të një ndërmarrje ka objektivin kryesor me stabilizuar ndërmarrjen, me pasur performancë pozitive dhe me krijuar të hyra të mjaftueshme që me i mbuluar shpenzimet operative të paktën.

Arianit Beqiri tha se këtë kompani është hera e tretë që po e subvencionojmë, kështu që do të ishte më së miri që ndërmarrja me qenë vetë në atë formë që ajo me pasë fitim edhe me e përfunduar këtë pjesën e borxhit. Sigurisht subvencionimi i ndërmarrjes gjithmonë është i mirëseardhur, mirëpo më së miri kishte me qenë që ato me pasë vetë përfitim. Situata me grumbullimin e mbeturinave në Prishtinë është kaotiek dhe mendoj se në këtë drejtim është punuar shumë pak.

Faton Zeka tha se është hera e tretë që po e subvencionojmë këtë ndërmarrje, dhe lidhur me këtë kërkoi të dijë se, a kanë vendosur edhe kuvendet komunale të komunave të tjera me ndarë mjete njetë, apo vetëm Prishtina është që e mbulon këtë barrë të ndërmarrjes "Pastrimi" në borxhin ndaj KMDK-së.

Lidhur me shqetësimet dhe çështjet e ngritura rreth subvencionimit të ndërmarrjes "Pastrimi", sqarime të nevojshme dhanë Bekim Brestovci, drejtor, Valbona Makolli, drejtore dhe Fatos Dibra, përfaqësues i Zyres ligjore.

Kryesuesi konstatoi se më 14 vota për, 1 kundër dhe 10 abstenime, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për kompaninë e menaxhimit të deponive në Kosovë KMDK SHA.

Pika e pestë

Propozimi-vendimi për ndryshimin e riparcelimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (të banimit individual) të Planit rregullues "Prishtina e Re-Zona perëndim" dhe ndërrimi i destinimit të BLL.I-1 ,Q-2, I-2 sipas destinimit të PZHU-së në Prishtinë.

Para se të fillohet me diskutimin e kësaj pike të rendit të ditës, kryesuesi konstatoi se në mungesë të kuorumit, mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 17:15.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina



Faqe9nga9